FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 67

Tiranë – E premte, 10 maj 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 9.5.2019	Për shpallje ditë zie kombëtare	5031
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 7, datë 26.4.2019	Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2019, sesioni i dytë	5031
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, datë 26.4.2019	Për datat dhe organizimin e provimeve të maturës shtetërore 2019, sesioni i dytë	5032
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 165, datë 7.5.2019	Për delegimin e kompetencave	5033
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193, datë 3.5.2019	Për miratimin e rregullores për funksionimin e portit të përpunimit të lëndëve djegëse për shoqërinë koncesionare "Porti MBM" në Romano Port Durrës	5034
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 194, datë 3.5.2019	Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e strukturës të sigurisë portuale të "Portit MBM" në Romano Port Durrës"	5034
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 296, datë 2.5.2019	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Fierzës	5034
Urdhër i Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 117, datë 7.5.2019	Për delegim kompetencash	5035
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 62, datë 23.4.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë "GEN-I tirana" sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46, datë, 19.3.2019 "Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a., për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e OSHEE sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit"	5036

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 63, datë 23.4.2019	Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.'", të ndryshuar.....	5037
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 64, datë 23.4.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e "Englatina Xhoxhaj" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik "Lugano", me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.....	5040
Vendim Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 245, datë 7.5.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	5042
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 246, datë 7.5.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	5045
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 247, datë 7.5.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Korçë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	5048
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 253, datë 8.5.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	5051
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 254, datë 8.5.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	5053
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 941/2, datë 6.5.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Komuna e Parisit–Rruga e Re Tiranë–Elbasan" (shtesa).....	5058
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2450/3, datë 6.5.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për zgjerimin e varrezave në fshatin Roshnik", Berat.....	5058
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 6689, datë 6.5.2019	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje me Kosovën.....	5059
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 6783, datë 7.5.2019	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje.....	5059
Vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë, datë 22.1.2019	Për hapjen e procedurave të likuidimit vullnetar të bankës.....	5059

VENDIM
Nr. 280, datë 9.5.2019

PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre", të pikave 2 e 3, të nenit 45, të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 12, të kapitullit VI, të Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, bashkëlidhur vendimit nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zie kombëtare, ditën e premte, datë 10.5.2019, në nderim të nëntetar Zarife Muharrem Hasanaj, rënë në krye të detyrës gjatë përmbushjes së misionit ushtarak jashtë vendit.

2. Në të gjitha institucionet shtetërore e publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmështizë dhe në orën 12:00 të mbahet një minutë heshtje.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të ndjekë organizimin e ceremonialit dhe të përballojë shpenzimet e varrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 7, datë 26.4.2019

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2019, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 dhe 50, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 98, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)",

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, për vitin shkollor 2018–2019, do të zhvillohen si më poshtë:
   a) Gjuhë e huaj: 20 gusht 2019 ,
   b) Gjuha shqipe: 23 gusht 2019 ,
   c) Matematikë: 28 gusht 2019.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën "Gjuhë amtare". Provimi kombëtar i arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën "Gjuhë amtare", do të zhvillohet më 19 gusht 2019.

3. Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2019, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në urdhrin nr. 774, datë 22.11.2018, "Për miratimin e rregullores për "Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018–2019".

4. Provimet kombëtare të arsimit bazë 2019, sesioni i dytë, fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

5. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren "Për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018–2019".

6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën "Gjuhë amtare", sesioni i dytë, përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastër. Në ditën e provimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar Delvinë dhe Sarandë, tërheqin tezën në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastër.

7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën "Gjuhë amtare", sesioni i dytë, përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit

nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë.

8. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.

9. Arkivimi i testeve bëhet pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

10. Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, dhe raporton në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

UDHËZIM
Nr. 8, datë 26.4.2019

PËR DATAT DHE ORGANIZIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2019, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2019, sesioni i dytë, të jenë:

a) Gjuhë e huaj: 27 gusht 2019,

b) Gjuhë shqipe dhe letërsi : 30 gusht 2019,

c) Matematikë: 3 shtator 2019,

d) Provimi me zgjedhje : 6 shtator 2019.

2. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2019, sesioni dytë, bazohet në rregulloren e maturës shtetërore 2019, miratuar me urdhrin nr. 780, datë 23.11.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të maturës shtetërore 2019, sesioni i dytë:

a) fillojnë në orën 10:00;

b) provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta;

c) testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA);

d) testi për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje vlerësohet me 60 pikë.

4. Në provimet e maturës shtetërore 2019, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:

a) maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të maturës shtetërore 2019, sesioni i parë;

b) maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2018–2019 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 22 gusht 2019;

c) kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2018, por që nuk kanë shlyer detyrimet e maturës shtetërore;

d) kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit dhe kanë të njësuar dokumentet shkollore nga QSHA-ja dhe kanë detyrime të maturës shtetërore.

5. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4, germa "c" dhe "d", të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar në vendbanimin e tyre.

6. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 4, germat "c" dhe "d", të plotësojnë formularin AlZ për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të maturës shtetërore, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë. Këta kandidatë të plotësojnë formularin A1Z në datat 21–23 gusht 2019.

7. Drejtori i shkollës të dërgojë zyrtarisht në institucionin arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e maturës shtetërore 2019, sesioni i dytë, në datën 23 gusht 2019.

Drejtori i institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 24 gusht 2019.

8. Provimet të zhvillohen të përqendruara në institucionin arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar. Institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar të përcaktojnë mjediset ku maturantët/kandidatët do të zhvillojnë provimin, duke mundësuar përqendrimin e tyre sipas kushteve dhe numrit të maturantëve/kandidatëve.

9. Institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e shkollave të marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, mjedisin dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e maturës shtetërore 2019, sesioni i dytë.

10. Drejtori i institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, brenda datës 20 gusht 2019, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe MASR-në për mjedisin ku do të zhvillohen provimet e maturës shtetërore 2019, sesioni i dytë, si dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e maturës shtetërore 2019, sesioni i dytë.

11. Në institucionin arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, ku numri i maturantëve/kandidatëve është më i madh se 500, të përdoren 2 mjedise.

12. Monitorimi dhe administrimi i procesit të maturës shtetërore 2019, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MASR-së dhe të institucioneve të varësisë.

13. Shpenzimet e përfaqësuesve të MASR-së, në monitorimin e provimeve të maturës shtetërore 2019, sesioni i dytë, të mbulohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi nga institucionet e përcaktuara në këtë udhëzim.

14. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE SHKENCËS
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 165, datë 7.5.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, znj. Belinda Ikonomi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, deleguar sipas pikës 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 8.5.2019 deri më 9.5.2019.

3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, znj. Belinda Ikonomi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 193, datë 3.5.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E PORTIT TË PËRPUNIMIT TË LËNDËVE DJEGËSE PËR SHOQËRINË KONCESIONARE "PORTI MBM" NË ROMANO PORT DURRËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 401, germa "b", të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare 'Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947'", dhe ligjit nr. 9594, datë 27.7.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare 'Për parandalimin e ndotjeve nga anijet 1973–1978 (MARPOL 73/78)'",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për funksionimin e portit të përpunimit të lëndëve djegëse për shoqërinë koncesionare "Porti MBM" në Romano Port Durrës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet "Porti MBM", Romano Port Durrës për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 194, datë 3.5.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS TË SIGURISË PORTUALE TË "PORTIT MBM" NË ROMANO PORT DURRËS"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 401, germa "b", të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947", dhe nenit 5, pika "b", e ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013 "Për sigurinë në anije dhe në porte",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e strukturës të sigurisë portuale të 'Portit MBM' Romano Port Durrës", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet "Porti MBM", Romano Port Durrës për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 296, datë 2.5.2019

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E FIERZËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 "Për peshkimin", i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhja në treg ose për konsum i të gjitha llojeve të peshqve të familjes së krapit në liqenin e Fierzës për periudhën 1.5.2019 deri më 31.5.2019.

2. Ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën breg/liqenore prej 150 ml nga bregu për periudhën 1.6.2019 deri më 30.6.2019.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të.

4. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me OMP-në, e cila ushtron aktivitet peshkimi në këtë liqen.

5. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në vartësi të së cilës është Sektori i Inspektimit e Kontrollit të Peshkimit, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të qarkut Kukës, që të monitorojnë zbatimin e Planit Operativ të Veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore të bashkive Kukës, Has, Tropojë dhe Fushë-Arrës, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në qarkun e Kukësit e Shkodrës, si dhe me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit të qarkut Kukës e Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

URDHËR
Nr. 117, datë 7.5.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 12, pikat 1 dhe 13, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenit 7, pika 3, të rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetutës", e ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Luan Daci, si vijon:

a) nënshkrim kërkese drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, për tërheqjen e dokumentacionit që ka kërkuar kryesuesja e çështjes për heqjen dorë të anëtares së trupit gjykues znj. Natasha Mulaj nga shqyrtimi i çështjes (JR) nr. 34/2018, datë 13.11.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Malaj, sipas ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik dhe përcjelljen e këtij dokumentacioni pas evidencimit nga protokolli i Kolegjit te kryesuesja e çështjes;

2. Delegimi i kompetencave të mësipërme është vetëm sipas pikës 1, germa "a", të këtij urdhri.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Luan Daci.

4. Z. Luan Daci nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Natasha Mulaj

VENDIM
Nr. 62, datë 23.4.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "GEN-I TIRANA" SHPK PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 46, DATË, 19.3.2019 "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OSHEE SHA PËR SHTYRJEN PËR NJË PERIUDHË TRANZITORE TË AFATIT TË PAGESËS SË FATURAVE PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREG TË PARREGULLUAR, NGA ANA E OSHEE SHA DHE ÇËSHTJE TË TJERA TË RREGULLIMIT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 53, nenit 56 dhe nenit 59, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", nenit 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.4.2019 mbasi shqyrtoi arsyetimin dhe shpjegimet e relacionit të drejtorive teknike, pjesë integrale e këtij vendimi, mbi kërkesën e shoqërisë "GEN-I Tirana" sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46, datë 19.3.2019,

konstatoi se:

- Shoqëria "GEN-I Tirana" sh.p.k., me anë të shkresës së saj nr. 64/18 prot., datë 3.4.2019, ka përcjellë në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46 datë, 19.3.2019 "Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e OSHEE sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit".

- Shoqëria "Gen-I Tirana" sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 74, seria T08P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 130, datë 2.12.2008, për një afat 5-vjeçar dhe rinovuar së fundmi me vendimin nr. 202, datë 13.9.2018, të Bordit të ERE-s.

- Në kuptim të vendimit ndaj të cilit është kërkuar rishikim, kërkuesi legjitimohet në cilësinë e palës së interesit.

- Për sa u përket afateve të depozitimit të një kërkese për rishikim të vendimeve të ERE-s "Rregullorja e organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, parashikon:

Neni 16 – Ridëgjimi dhe ankimi kundër vendimit të Bordit 1. Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Shoqëria "GEN-I Tirana" sh.p.k., siç provohet nga procesverbali i mbledhjes së datës 19.3.2019, është përfaqësuar në mbledhjen e Bordit të ERE-s me anë të përfaqësuesit të saj z. Sokol Spahia, i cili ka marrë dijeni rregullisht në lidhje me vendimmarrjen e Bordit dhe ka parashtruar argumentimet e tij në lidhje me këtë vendimmarrje.

- Neni 149, i ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative, parashikon se: njoftimi që i bëhet përfaqësuesit ose personit përgjegjës të njoftimeve, vlerësohet se i është bërë personalisht palës (procesverbali i nënshkruar nga përfaqësuesi I GEN-I Tirana sh.p.k. z. Sokol Spahia).

- Kërkesa për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s nga shoqëria "GEN-I Tirana" sh.p.k., nuk reflekton parashikimet e nenit 16 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", që parashikon një afat prej 7 ditësh kalendarike për depozitimin e kërkesës për rishikim të një vendimi të Bordit të ERE-s, referuar datës së marrjes dijeni mbi të. Kërkesa është depozituar 14 ditë pas marrjes në dijeni (shkresa e "GEN-I Tirana" sh.p.k. me nr. 64/18 prot., datë 3.4.2019).

- Së bashku me kërkesën për rishikim, shoqëria "GEN-I Tirana" sh.p.k. ka depozituar në ERE shkresat si më poshtë:

- shkresë: Tiranë, 2 prill, 2019 nr. Ref. 607/2019/MP;

- vendimi i Bordit të ERE-s nr. 26, datë 28.2.2019;

- letër e ERE-s për OSHEE-në dhe GEN-I Tirana nr. 64, datë 23.1.2019;

- letër e GEN-I Tirana për ERE-n, datë 21.12.2018;

- letra e ERE-s për GEN-I Tirana nr. prot. 64/13, datë 7.3.2019;

- vendim i Bordit të ERE-s me nr. 46 datë, 19.3.2019;

- Të gjitha dokumentet bashkëlidhur janë dokumente ose të lëshuara nga ERE, drejtuar apo në dijeni të ERE-s, ose vendimmarrje të Bordit të ERE-s përpara marrjes së vendimit për të cilin është kërkuar rishikimi.

- Në këtë kuptim, asnjë nga dokumentet bashkëlidhur nuk përbën prove të re, që mund ta çojë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

- Për sa u përket argumenteve të përdorur për të kërkuar rishikimin e vendimit nga pala kërkuese e rishikimit, asnjëri prej tyre, nuk është apo përbën një provë apo argument të ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "Gen-I Tirana" sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46, datë 19.3.2019 "Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e OSHEE sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit", si të pambështetur në prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara në kuptim të nenit 16 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s".

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë kërkuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 63, datë 23.4.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 179, DATË 8.11.2017, "MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË 'OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR" ALBGAZ SHA'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 37, nenit 50, nenit 59, nenit 68, dhe nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", nenit 6, nenit 7, nenit 8, nenit 9, nenit 10 dhe nenit 11 të "Rregullores për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror", miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, të Bordit të ERE-s dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.4.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përpiluar nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut në lidhje me një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.'", të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 236, datë 2.11.2018, vendosi:

1. Afatet e përcaktuara në pikat 2, 3, 5, 5.2 dhe 7, të dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.'", të shtyhen deri në datën 10.4.2019.

2. Afati i përcaktuar në pikën 4, "… si dhe duhet që të hartojë dhe t'i dorëzojë ERE-s, raportin e përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të "Albgaz" sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21, të direktivës nr. 73/2009, të Komisionit Evropian, "Mbi rregullat për tregun e gazit natyror" dhe nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, "Për

sektorin e gazit natyror", shtyhet deri në datën 10.4.2019. "Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.'".

- Shtyrja e këtij afati të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 236, datë 2.11.2018, u bë pasi u provua nga ana e shoqërisë "Albgaz" sh.a., pamundësia për të përmbushur të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.'".

- Shoqëria "Albgaz" sh.a. ende nuk i ka përmbushur tërësisht kërkesat e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.'", të ndryshuar, si vijon:

- Në lidhje me përmbushjen e kushteve të parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.'" konstatojmë sa parashikuar dhe sa realizuar si në vijim:

- Pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017.

- Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, "Albgaz" sh.a. të zëvendësojë përfaqësuesit e MIE-it te Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë me anëtarë të cilët nuk janë të punësuar te MIE ose te kompanitë e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo.

- Pas vendimmarrjes së ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror'", për plotësimin e pikës 2 të saj, audituesi financiar i "Albgaz" sh.a. duhet të jetë i pavarur, në kuptimin që audituesi financiar nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen detyra ose kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror. Në lidhje me këtë çështje, "Albgaz" sh.a. duhet t'i kërkojë Asamblesë së Përgjithshme (MEF) sigurimin e shmangies së emërimeve të audituesve financiarë të njëjtë, rezulton se "Albgaz" sh.a. ka bërë ndryshimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në zbatim të urdhrit nr. 130, datë 14.11.2017 dhe urdhrit nr. 234, datë 6.3.2018, i ndryshuar.

- Pika 3 e dizpositivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017.

"Albgaz" sh.a. të raportojë çdo muaj në ERE procedurën për regjistrimin e aseteve të transmetimit dhe ta përfundojë procedurën brenda gjashtë muajve pas miratimit të vendimit përfundimtar.

Në lidhje me plotësimin e këtij kushti nga korrespondencat e shoqërisë "Albgaz" sh.a. në ERE, si dhe me të fundit nr. 266, datë 1.4.2018, shoqëria ka bërë me dije që shoqëria "Albgaz" është pajisur me certifikatën e pronësisë, për:

1. Sheq i Madh (data e lëshimit të certifikatës 9.8.2017);

2. Fier Drizë truall me nr. pasurie 93 (data e lëshimit të certifikatës 9.11.2017);

3. Fier Gjonçe truall me nr. pasurie 267/10 (data e lëshimit të certifikatës 9.11.2017);

4. Lavdan, Mallakastër me nr. pasurie 549 (data e lëshimit të certifikatës 18.12.2017).

Në përgjigje të shkresës së ERE-s me nr. 266/1 prot., datë 5.4.2019, ka përcjellë praktikë dokumentare në lidhje aplikimin e vitit 2018, pranë ZRVPP-së për pajisjen me dokument pronësie për tri pasuri dhe është në pritje të përgjigjes nga ZVRP-ja përkatëse.

- Cërrik Elbasan, me nr. pasurie 12/289;

- Drenovë, Mallakastër, me nr. 1/6 pasurie;

- Balldren, Elbasan, me nr. A pasurie, e ndodhur në zonën kadastrale nr. 10/85.

Pika 4 e dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017.

Brenda 3 muajve pas miratimit të vendimit të certifikimit, "Albgaz" sh.a. të caktojë Zyrtarin e Përputhshmërisë subjekt i miratimit nga ERE, si dhe duhet që të hartojë dhe t'i dorëzojë ERE-s, Raportin e përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të "Albgaz" sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të direktivës nr.73/2009 të Komisionit Evropian, "Mbi rregullat për tregun e gazit natyror" dhe nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

Në lidhje me këtë kusht rezulton se ERE, me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017, ka miratuar Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, në

germën "C", pika 73, të të cilit sanksionohet se: "Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], zyrtari i përputhshmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST-së me këtë program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-së".

Në seksionin VII, pika 76, e programit të përputhshmërisë, citohet se: Ky program duhet të miratohet me vendimin e [organit përgjegjës] të kompanisë OST dhe, brenda 5 (pesë) ditëve pas përshtatjes së tij ky vendim duhet të dorëzohet në ERE për miratim. Ky Program duhet të hyjë në fuqi ditën tjetër pas miratimit nga ERE.

Në lidhje me këtë kusht Shoqëria Albgaz sh.a. s'ka asnjë pengesë që të dorëzojë për miratim në ERE, Programin e Përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017. "Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror".

Pika 5 e dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017.

Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të rekomandimeve në Opinionin e Sekretariatit, "Albgaz" sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregon garancinë në lidhje me:

5.1 Pavarësinë e Audituesve Financiarë Audituesi financiar i "Albgaz" sh.a. duhet të jetë i pavarur, nënkuptimin që audituesi financiar nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen detyra ose kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror. Në lidhje me këtë çështje, "Albgaz" sh.a. duhet t'i kërkojë Asamblesë së Përgjithshme sigurimin e shmangies së emërimeve të audituesve financiarë të njëjtë.

Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 5.1 të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, në lidhje me pavarësinë e audituesve financiarë, rezulton se shoqëria "Albgaz" sh.a. ka depozituar në ERE dy deklarata për punonjësit e auditimit të "Albgaz" sh.a. në funksion të ndarjes së aktiviteteve në ndërmarrjet e energjisë lidhur me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror. Këto struktura kryejnë veprimtarinë e auditimit të brendshëm të shoqërisë.

Nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se shoqëria "Albgaz" sh.a ka depozituar pasqyrat financiare për vitin 2017, të nënshkruara nga tre ekspertë kontabël të cilët janë të ndryshëm nga ata të emëruar e që kryejnë këtë veprimtari për "Albpetrol" sh.a.

Sa më sipër plotëson kushtin e ndarjes së detyrës së auditimit financiar të shoqërisë, në pavarësi nga "Albpetrol" sh.a.

Plotësimi i kushteve sa më sipër, nuk çliron "Albgaz" sh.a. nga detyrimi për të raportuar në ERE çdo vit për audituesit ligjorë që kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore të vitit, në zbatim të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017 dhe ligjit nr. 47/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të regjistruar dhe të Kontabilistit të miratuar", të ndryshuar.

- 5.2 dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017

- Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, nenet 11 dhe 46 (10) i ligjit për sektorin e gazit natyror dhe transferimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimit, "Albgaz" sh.a. do t'i paraqesë ERE-s provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i "Albgaz" sh.a., Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë ndodhur janë efektive.

Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, për bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, nenet 11 dhe 46 (10) i ligjit për sektorin e gazit natyror dhe transferimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë, shoqëria "Albgaz" sh.a. ka përcjellë pranë MIE-it kërkesën me nr. 125 prot., datë 5.11.2018, ku, ndër të tjera, ka kërkuar zgjidhje edhe për plotësimin e këtij kushti, por nuk ka ende asnjë përgjigje prej saj.

Veç sa më sipër edhe ERE, së fundmi, me shkresën nr. 233/2 prot., datë 20.4.2018, ka kërkuar mbështetjen e MIE-it për zbatimin e parashikimeve të vendimit të certifikimit të "Albgaz" sh.a.

Në vijim të raportimit dhe konstatimeve sa më sipër, për shkak të rrethanave të cilat siç shpjeguar nuk varen nga vullneti i "Albgaz" sh.a. për të zbatuar parashikimet e vendimit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, ky i fundit i është drejtuar ERE-s, me kërkesën për shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të kërkuar nga vendimi nr. 179, datë 8.11.2017, deri në datën 20.12.2019, dhe bën me dije se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e pikave të kërkuara në këtë vendim.

Në lidhje me këtë kërkesë, Kodi i Procedurave Administrative, neni 53 i tij parashikon që: afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

Konstatojmë se ndodhemi në këto kushte, pasi kërkesa e "Albgaz" sh.a. është depozituar në ERE me shkresën nr. 266, datë 1.4.2019, dhe duke marrë në konsideratë që afati i vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, i ndryshuar, plotësohet në datën 10.4.2019, shqyrtimi i kësaj kërkese përpara përfundimit të afatit, plotëson kushtet sa më sipër.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, shfuqizohet.

2. Pika 3 e vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, ndryshon dhe bëhet: "3. "Albgaz" sh.a. të përfundojë brenda tre muajve procedurat e aplikimit pranë institucioneve përgjegjëse për pajisjen me certifikata pronësie për të gjitha asetete që disponon.".

3. Pika 4, e vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, ndryshon dhe bëhet: "Shoqëria "Albgaz" sh.a. të dorëzojë për miratim në ERE deri në datën 31 maj 2019, programin e përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE, me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017, e Bordit të ERE-s, "Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror".

4. Pika 5.1, e vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, ndryshohet dhe bëhet: ""Albgaz" sh.a. të paraqesë në ERE deklaratat e audituesve financiarë dhe pasqyrat financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor.".

5. Afati i përcaktuar në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, të shtyhet deri në datën 20.12.2019.

6. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të përcjellë këtë vendim pranë "Albgaz" sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 64, datë 23.4.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E "ENGLATINA XHOXHAJ" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK "LUGANO", ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, NË ZONËN SHEQ MARINAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA FIER, QARKU FIER

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a"; nenit 5, pika 1, germa "a"; nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.4.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për licencimin e "Englantina

Xhoxhaj" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik "Lugano", me kapacitet të instaluar 2 mw,

konstatoi se:

- Personi fizik "Englantina Xhoxhaj" sh.p.k., me shkresën nr. 240 prot., datë 21.3.2019, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik "Lugano", me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Znj. Englantina Xhoxhaj, e regjistruar si personi fizik me vendimin të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 14331, datë 8.5.2000, bazuar në nenet 2 dhe 5, të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", i ndryshuar, është mbajtës i miratimit përfundimtar me nr. 9310/2, datë 19.12.2018.

- Neni 37, pika 1, e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë", i ndryshuar, parashikon se: Çdo person juridik, që kryen një veprimtari në sektorin e energjisë elektrike, sipas pikës 2, të këtij neni, duhet të pajiset me licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

- Për sa më sipër cituar, personi juridik Englantina Xhoxhaj sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 240/2, datë 8.4.2019, ka përcjellë sqarime lidhur me aplikimin për licencë për Centralin Fotovoltaik "Lugano", me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën e Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Në vijim të kërkesës për licencim, Englantina Xhoxhaj, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 240/1, datë 3.4.2019, ka bërë me dije ERE-n lidhur me ndryshimin e statusit juridik dhe krijimin e shoqërisë "Eglantina Xhoxhaj" sh.p.k., e regjistruar në QKB me NUIS L92801402B, datë regjistrimi 1.4.2019, me seli në Fier.

- Nga korrespondenca nr. 240/1, datë 3.4.2019, rezulton se, përveç ERE-s, personi juridik Englantina Xhoxhaj sh.p.k. ka bërë më dije për këtë ndryshim edhe MIE-n, AKBN-në dhe OSHEE sh.a.

- Neni 3, i ligjit nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", parashikon që: Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Eglantina Xhoxhaj" sh.p.k., është themeluar nga personi fizik Eglantina Xhoxhaj, mbajtëse e miratimit përfundimtar me nr. 9310/2, datë 19.12.2018, dhe kontratës nr. 6583 rep. dhe nr. 2075 kol., datë 29.12.2018, të lidhur ndërmjet MIE-it dhe personit fizik "Englantina Xhoxhaj" "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik "Lugano", me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Topojë, qarku Fier.

- Aplikimi i kryer nga personi fizik, themelues i personit juridik, i cili ka tagrin e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik "Lugano", plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "f") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "b", dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.4.3, germat "a", "b", "d"; 4.4.4, germat "b", "c", "d"; 4.5, germat "a", "b") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Shoqëria "Eglantina Xhoxhaj" sh.p.k. kërkon nga ERE vijimin e procedurës së licencimit për prodhimin e energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik "Lugano", për subjektin "Eglantina Xhoxhaj" si sh.p.k., e regjistruar në QKB, me NUIS L92801402B, duke pretenduar se nuk ka ndryshuar aksioneri, por vetëm statusi i shoqërisë.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 2, germa "c", "d", "g" (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria) dhe germa "e" (struktura e ndërtimit, lista e personelit sipas profilit në përputhje me aktivitetin);

- nenin 9, pika 3, germa "a" (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave) dhe pika "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- nenin 9, pika 4.4.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin), do të njoftohet personi, që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Do t'i kërkohet "Eglantina Xhoxhaj", që në vijim të depozitojë në ERE qëndrimin e MIE-it lidhur me njohjen e këtij ndryshimi të formës juridike të personit mbajtëse të miratimit përfundimtar me nr. 9310/2, datë 19.12.2018, dhe kontratës nr. 6583 rep. dhe nr. 2075 kol., datë 29.12.2018, të lidhur ndërmjet MIE-it dhe personit fizik "Englantina Xhoxhaj" "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik "Lugano", me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Topojë, qarku Fier.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e "Englantina Xhoxhaj" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik "LUGANO", të ndodhur në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 245, datë 7.5.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,
shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, të znj. Jorida Hasan Tabaku.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Tiranë, të subjektit politik Partia Demokratike.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin

e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 qershor 2017, ka fituar 11 (njëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, janë: numri rendor 1 (një) z. Lulzim Xhelal Basha, numri rendor 2 (dy) znj. Orjola Hysni Pampuri, numri rendor 3 (tre) znj. Rudina Azem Hajdari, numri rendor 4 (katër) znj. Grida Agim Shqina (Duma), numri rendor 5 (pesë) znj. Albana Sadik Vokshi, numri rendor 6 (gjashtë) znj. Jorida Hasan Tabaku, numri rendor 7 (shtatë) z. Sali Ram Berisha, numri rendor 8 (tetë) z. Halim Marsut Kosova, numri rendor 9 (nëntë) z. Gent Hysen Strazimiri, numri rendor 10 (dhjetë) z. Fatmir Ali Mediu, dhe numri rendor 11 (njëmbëdhjetë) z. Dashamir Hamit Shehi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në Zonën Zgjedhore qarku Tiranë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Tiranë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 22 (njëzet e dy), 23 (njëzet e tre), 24 (njëzet e katër), 36 (tridhjetë e gjashtë), 37 (tridhjetë e shtatë), 39 (tridhjetë e nëntë), 42 (dyzet e dy), 47 (dyzet e shtatë), 49 (dyzet e nëntë), 12 (dymbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 54, 55, 56, 57 datë 12.3.2019, vendimin nr. 70, datë 20.3.2019, si dhe vendimet nr. 101, 103, 104, 105, datë 27.3.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 45 datë 11.3.2019, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit znj. Majlinda Skënder Halilaj, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Lulzim Xhelal Basha.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Tiranë, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 13 (trembëdhjetë), 14 (katërmbëdhjetë), 15 (pesëmbëdhjetë), 16 (gjashtëmbëdhjetë), 17 (shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), 19 (nëntëmbëdhjetë), 20 (njëzet), 21 (njëzet e një). Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 115, nr. 116, nr. 120, nr. 121, datë 4.4.2019, vendimin nr. 165, datë 16.4.2019, vendimin nr. 174, datë 18.4.2019, vendimin nr. 175, 18.4.2019 dhe vendimin nr. 190, datë 23.4.2019 ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë, të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 125, datë 4.4.2019, ka vendosur t'i

japë mandatin e deputetit z. Korab Qamil Lita, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Orjola Hysni Pampuri.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 25 (njëzet e pesë), 26 (njëzet e gjashtë), 27 (njëzet e shtatë), 28 (njëzet e tetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 157, nr. 158, nr. 159, datë 16.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 181, datë 18.4.2019, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Erion Hysen Piciri, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Grida Agim Shqina (Duma).

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 29 (njëzet e nëntë), 30 (tridhjetë), 31 (tridhjetë e një), 32 (tridhjetë e dy), 33 (tridhjetë e tre), 34 (tridhjetë e katër) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 193, datë 23.4.2019, vendimin nr. 210, datë 25.4.2019, vendimin nr. 214, datë 25.4.2019, si dhe me vendimet nr. 219, nr. 222, datë 27.4.2019, ka vendosur të shpallë ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 185 datë 23.4.2019, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Artur Daut Roshi, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Albana Sadik Vokshi.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 35 (tridhjetë e pesë), 38 (tridhjetë e tetë), 40 (dyzet), 41 (dyzet e një), 43 (dyzet e tre), 44 (dyzet e katër), 45 (dyzet e pesë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit ne zbatim te ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 220, datë 27.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të Kandidateve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularëve të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalia e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 35 (tridhjetë e pesë), z. Indrit Fatmir Hoxha.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2532 prot., datë 24.4.2019, z. Indrit Fatmir Hoxha, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Z. Indrit Fatmir Hoxha, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 24.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2141, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Indrit Fatmir Hoxha, rezulton se: Nuk ka deklaruar dënime penale, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Indrit Fatmir Hoxha, rezulton se, në seksionin III "Të dhëna mbi

gjendjen gjyqësore të personit", në pikën nr. 4 "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale", i është përgjigjur "Po" dhe ka deklaruar se:

- është shoqëruar në Komisariatin nr. 2 Tiranë, më datë 1.9.2014, ora 18:15'
- është shoqëruar në Komisariatin nr. 1 Tiranë, më datë 6.3.2016, ora 18:03'
- është arrestuar nga Drejtoria e Policisë Tiranë, më datë 28.3.2016 për arsye shkatërrim prone.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b", dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2556 prot., datë 25.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2555 prot., datë 25.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Indrit Fatmir Hoxha.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1268/1 prot., datë 30.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Indrit Fatmir Hoxha sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i dokumentacionit (të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe vërtetimit të gjendjes gjyqësore) sipas nenit 2, dhe nenit 4, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", rrethanat e paraqitura nga z. Indrit Fatmir Hoxha, nuk përfshihen në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t'u zgjedhur në funksionin e deputetit.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës të listës shumemërore të Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 35 (tridhjetë e pesë), z. Indrit Fatmir Hoxha.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, z. Indrit Fatmir Hoxha.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM
Nr. 246, datë 7.5.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU DURRËS, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri:	kryetar;
Denar Biba:	zv.kryetar;
Bledar Skënderi:	anëtar;
Edlira Jorgaqi:	anëtare;
Rezarta Bitri:	anëtare,

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Oerd Eqrem Bylykbashi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Durrës të subjektit politik Partia Demokratike.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 4 (katër) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Durrës, janë numri rendor 1 (një) z. Oerd Eqrem Bylykbashi, numri rendor 2 (dy) znj. Fatbardha Mirban Kadiu, numri rendor 3 (tre) z. Edi Tonin Paloka, numri rendor 4 (katër) z. Florjon Prokop Mima.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Durrës, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore Durrës, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Durrës, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 9 (nëntë), 13 (trembëdhjetë), 5 (pesë), 6 (gjashtë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 72, vendimin nr. 79, datë 20.3.2019, vendimin nr. 94, vendimin nr. 95, datë 27.3.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Durrës, kanë shteruar.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër 7 (shtatë), 8 (tetë), 10 (dhjetë), 11 (njëmbëdhjetë),

dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 163, vendimin nr. 166, datë 16.4.2019, vendimin nr. 131, datë 9.4.2019 dhe vendimin nr. 209, datë 25.4.2019 ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 12 (dymbëdhjetë), 14 (katërmbëdhjetë), 15 (pesëmbëdhjetë), 16 (gjashtëmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 189, datë 23.4.2019, vendimin nr. 206, vendimin nr. 207, datë 25.4.2019 dhe vendimin nr. 221, datë 27.4.2019, ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numer rendor 17 (shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), 19 (nëntëmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 " Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalia e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), z. Kujtim Bajram Gjuzi.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2572 prot., datë 26.4.2019, z. Kujtim Bajram Gjuzi, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Z. Kujtim Bajram Gjuzi, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 26.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2142, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Kujtim Bajram Gjuzi, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2579 prot., datë 27.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2580 prot., datë 27.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Kujtim Bajram Gjuzi.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vëtëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1267/1 prot., datë 30.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Kujtim Bajram Gjuzi, sipas të cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Kujtim Bajram Gjuzi, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumemërore të Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Durrës, i renditur me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), z. Kujtim Bajram Gjuzi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Durrës, z. Kujtim Bajram Gjuzi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM
Nr. 247, datë 7.5.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU KORÇË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,
shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Korçë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Klevis Fahri Balliu.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164 pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.0=2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Korçë, të subjektit politik Partia Demokratike.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin

e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Korçë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 4 (katër) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Korçë, janë numri rendor 1 (një) znj. Valentina Pandi Duka, numri rendor 2 (dy) z. Ervin Bujar Salianji, numri rendor 3 (tre) z. Hekuran Bujar Hoxhalli, numri rendor 4 (katër) z. Klevis Fahri Balliu.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Korçë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Korçë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Korçë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 9 (nëntë), 11 (njëmbëdhjetë), 5 (pesë), 6 (gjashtë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 74, vendimin nr. 81, datë 20.3.2019, vendimin nr. 97, datë 27.3.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 62, datë 12.3.2019 ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Ligoraq Jorgji Karamelo, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Ervin Bujar Salianji.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Korçë, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 7 (shtatë), 8 (tetë), 10 (dhjetë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 129, datë 9.4.2019, vendimin nr. 147, datë 11.4.2019, ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 136 datë 9.4.2019 ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Arlind Engjell Çaçani, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Valentina Pandi Duka.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumemërore me numër rendor 12 (dymbëdhjetë), 13 (trembëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 208, datë 25.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të

radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 179, datë 18.4.2019 ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Andi Petraq Përmeti, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Hekuran Bujar Hoxhalli.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumemërore me numër rendor 14 (katërmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalia e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 14 (katërmbëdhjetë), z. Koçi Tahir Tahiri.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2575 prot., datë 26.4.2019, z. Koçi Tahir Tahiri, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Z. Koçi Tahir Tahiri, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 26.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2145, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Koçi Tahir Tahiri, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2579 prot., datë 27.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2580 prot., datë 27.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Koçi Tahir Tahiri.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vëtëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1267/1 prot., datë 30.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Koçi Tahir Tahiri , sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Koçi Tahir Tahiri, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumemërore e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Korçë, i renditur me numër rendor 14 (katërmbëdhjetë), z. Koçi Tahir Tahiri.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Korçë, z. Koçi Tahir Tahiri.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM
Nr. 253, datë 8.5.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU DURRËS, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 8.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, të znj. Fatbardha Mirban Kadiu.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Durrës, të subjektit politik Partia Demokratike.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 4 (katër) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Durrës, janë numri rendor 1 (një) z. Oerd Eqrem Bylykbashi, numri rendor 2 (dy) znj. Fatbardha Mirban Kadiu, numri rendor 3 (tre) z. Edi Tonin Paloka, numri rendor 4 (katër) z. Florjon Prokop Mima.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Durrës, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore Durrës, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Durrës, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor, 9 (nëntë), 13 (trembëdhjetë), 5 (pesë), 6 (gjashtë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 72, vendimin nr. 79, datë 20.3.2019, vendimin nr. 94, vendimin 95, datë 27.3.2019 ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Durrës, kanë shteruar.

Në bazë të nenit 164 pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër 7 (shtatë), 8 (tetë), 10 (dhjetë), 11 (njëmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 163, vendimin nr. 166, datë 16.4.2019, vendimin nr. 131, datë 9.4.2019 dhe vendimin nr. 209, datë 25.4.2019 ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 12 (dymbëdhjetë), 14 (katërmbëdhjetë), 15 (pesëmbëdhjetë), 16 (gjashtëmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 189, datë 23.4.2019, vendimin nr. 206, vendimin nr. 207, datë 25.4.2019 dhe vendimin nr. 221, datë 27.4.2019, ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 17 (shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), 19 (nëntëmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalia e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Krenar Ramazan Rryçi.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2576 .prot., datë 26.4.2019, z. Krenar Ramazan Rryçi, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Z. Krenar Ramazan Rryçi, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë

funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 30.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2149, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Krenar Ramazan Rryçi, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2722 prot., datë 6.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2720 prot., datë 6.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Krenar Ramazan Rryçi.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vëtëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1328/1 prot., datë 7.5.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Krenar Ramazan Rryçi, sipas të cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat Shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Krenar Ramazan Rryçi, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumemërore të Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Durrës, i renditur me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Krenar Ramazan Rryçi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Durrës, z. Krenar Ramazan Rryçi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM
Nr. 254, datë 8.5.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 8.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri:	kryetar;
Denar Biba:	zv.kryetar;
Bledar Skënderi:	anëtar;
Edlira Jorgaqi:	anëtare;
Rezarta Bitri:	anëtare,

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Sali Ram Berisha.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Tiranë, të subjektit politik Partia Demokratike.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 11 (njëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, janë numri rendor 1 (një) z. Lulzim Xhelal Basha, numri rendor 2 (dy) znj. Orjola Hysni Pampuri, numri rendor 3 (tre) znj. Rudina Azem Hajdari, numri rendor 4 (katër) znj. Grida Agim Shqina (Duma), numri rendor 5 (pesë) znj. Albana Sadik Vokshi, numri rendor 6 (gjashtë) znj. Jorida Hasan Tabaku, numri rendor 7 (shtatë) z. Sali Ram Berisha, numri rendor 8 (tetë) z. Halim Marsut Kosova, numri rendor 9 (nëntë) z. Gent Hysen Strazimiri, numri rendor 10 (dhjetë) z. Fatmir Ali Mediu, dhe numri rendor 11 (njëmbëdhjetë) z. Dashamir Hamit Shehi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Tiranë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 22 (njëzet e dy), 23 (njëzet e tre), 24 (njëzet e katër), 36 (tridhjetë e gjashtë), 37 (tridhjetë e shtatë), 39 (tridhjetë e nëntë), 42 (dyzet e dy), 47 (dyzet e shtatë), 49 (dyzet e nëntë), 12 (dymbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 54, 55, 56, 57, datë 12.3.2019, vendimin nr. 70, datë 20.3.2019, si dhe vendimet nr. 101, 103, 104, 105, datë 27.3.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 45, datë 11.3.2019, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit znj. Majlinda Skënder Halilaj, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Lulzim Xhelal Basha.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Tiranë, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 13 (trembëdhjetë), 14 (katërmbëdhjetë), 15 (pesëmbëdhjetë), 16 (gjashtëmbëdhjetë), 17 (shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), 19 (nëntëmbëdhjetë), 20 (njëzet), 21 (njëzet e një). Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 115, nr. 116, nr. 120, nr. 121, datë 4.4.2019, vendimin nr. 165, datë 16.4.2019, vendimet nr. 174, nr. 175, datë 18.4.2019, si dhe vendimin nr. 190, datë 23.4.2019 ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 125, datë 4.4.2019, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Korab Qamil Lita, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Orjola Hysni Pampuri.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 25 (njëzet e pesë), 26 (njëzet e gjashtë), 27 (njëzet e shtatë), 28 (njëzet e tetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 157, nr. 158, nr. 159, datë 16.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 181, datë 18.4.2019, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Erion Hysen Piciri, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Grida Agim Shqina (Duma).

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 29 (njëzet e nëntë), 30 (tridhjetë), 31 (tridhjetë e një), 32 (tridhjetë e dy), 33 (tridhjetë e tre), 34 (tridhjetë e katër) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 193, datë 23.4.2019, vendimet nr. 210, nr. 214, datë 25.4.2019, si dhe vendimet nr. 219, nr. 222, datë 27.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet ne Kuvendin e Shqipërisë të Kandidateve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike si rezultat i mosdorëzimit të formularëve të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendim nr. 185, datë 23.4.2019, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Artur Daut Roshi, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Albana Sadik Vokshi, me vendim nr. 245, datë 7.5.2019, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Indrit Fatmir Hoxha, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Jorida Hasan Tabaku.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 35 (tridhjetë e pesë), 38 (tridhjetë e tetë), 40 (dyzet), 41 (dyzet e një), 43 (dyzet e tre), 44 (dyzet e katër), 45 (dyzet e pesë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 220, datë 27.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të Kandidateve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike si rezultat i mosdorëzimit të formularëve të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalia e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit është edhe kandidati për deputet me numër rendor 45 (dyzet e pesë), z. Kostaq Thanas Papa.

Referuar nenit 11, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të

dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2598 prot., datë 30.4.2019, z. Kostaq Thanas Papa, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Z. Kostaq Thanas Papa, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 30.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2148, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Kostaq Thanas Papa, rezulton se:

Emrin e ka ndryshuar nga "Kostandin" në "Kostaq";

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Kostaq Thanas Papa, rezulton se, në seksionin III "Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit", në pikën nr. 1 "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj", i është përgjigjur "Po" dhe ka deklaruar se:

Është dënuar me vendimin nr. 166, datë 27.2.2006, i Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, me 50000 lekë gjobë për veprën penale "Përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike", parashikuar nga neni 275, i K.Penal.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Kostaq Thanas Papa, rezulton se, në seksionin III "Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit", në pikën nr. 2 "A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë" i është përgjigjur "Jo" dhe ka deklaruar se:

Është dënuar me vendimin jo përfundimtar nr. 669, datë 26.12.2003, i Gjykatës së Shkallës Parë Durrës për veprën penale "Shpifje", parashikuar nga neni 120/2 i K.Penal, shfuqizuar nga me vendimin 144 nga Gjykata e Apelit Durrës.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Kostaq Thanas Papa, rezulton se, në seksionin III "Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit", në pikën nr. 4 "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale" i është përgjigjur "Po" dhe ka deklaruar se:

Është shoqëruar në Polici/Prokurori Durrës për arsye të vendimit të mësipërm 1-2 ditë, viti 2003.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Kostaq Thanas Papa, rezulton se, në seksionin III "Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit", në pikën nr. 5 "A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo" i është përgjigjur "Po" dhe ka deklaruar se:

Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore 1 herë në muaj, për shkak të vendimit të Gjykatës së Shkallës Parë Durrës për veprën penale "Shpifje", parashikuar nga neni 120/2 i K.Penal.

Masë e revokuar.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b", dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2722 prot., datë 6.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2720 prot., datë 6.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Kostaq Thanas Papa.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1328/1 prot., datë 7.5.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Kostaq Thanas Papa, sipas së cilës rezulton se është i rehabilituar për dënimin e dhënë nga

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 166, datë 27.2.2006 për të cilin është deklaruar fajtor për veprën penale të "Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike" dhe në bazë të nenit 275 të Kodit Penal, si dhe në aplikim të nenit 406, të K.Pr.Penale, dënohet përfundimisht me 50,000 (pesëdhjetëmijë) lekë gjobë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Me shkresën nr. 3540 prot., datë 30.5.2017, në lidhje me kandidatët e listës shumemërore të subjektit politik Partia Demokratike është kërkuar informacion pranë zyrës së gjendjes civile nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Me shkresën nr. 3540/1 prot., datë 6.7.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mbi verifikimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit politik Partia Demokratike, njofton se subjekti ka këto ndryshime në gjenealitetet e mëparshme, të padeklaruara në formularët e vetëdeklarimit:

Ka ndryshuar ditëlindjen nga "26.8.1963" në "25.8.1963".

Referuar germës ç, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi kur janë dënuar me jo më pak së 6 (gjashtë) muaj burgim.

Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

...

4. Për personat që parashikohen nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69, të Kodit Penal.

Z. Kostaq Thanas Papa për veprën penale, të "Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike", parashikuar nga neni 275, i Kodit Penal, për të cilën kandidati është dënuar me gjobë është rehabilituar sipas nenit 69/b të Kodit Penal. Në këtë rast kjo e dhënë nuk përbën shkak sipas germës "ç", pika 1, neni 2, të ligjit nr. 138/2015, për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit dhe ndërprerjen e mandatit, pasi ka përfunduar periudha e ndalimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit (të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe vërtetimit të gjendjes gjyqësore) rrethanat e paraqitura nga z. Kostaq Thanas Papa nuk përfshihen në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t'u zgjedhur në funksionin e deputetit sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës të listës shumemërore të Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 45 (dyzet e pesë), z. Kostaq Thanas Papa.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, z. Kostaq Thanas Papa.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

KËRKESË
Nr. 941/2, datë 6.5.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Komuna e Parisit–Rruga e Re Tiranë–Elbasan" (shtesa).

Subjekti kërkues i këtij projekti është ARRSH.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 3 626 125 (tre milionë e gjashtëqind e njëzetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT: NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KOMUNA E PARISIT–RRUGA E RE TIRANË–ELBASAN" (SHTESA)

Nr.	Emër mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqe shpronësimi		Vlera totale / lekë	Shënime Konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
						Tokë truall / m²			
1	Atlije Hajdar Brari	8280	1/61	truall	875	23	29,543	679,489	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Andi Pandeli Dervishi	8270	8/353	truall	234	5	66,969	334,845	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Bashkëpronarët Brari	8270	8/998	truall	115	39	66,969	2,611,791	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT								**3,626,125**	

KËRKESË
Nr. 2450/3, datë 6.5.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Për zgjerimin e varrezave në fshatin Roshnik", Berat.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasuritë e llojit "tokë arë" dhe udhëzimit nr. 1, datë 5.10.2000 "Për kriteret teknike të përllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutorë që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes, për pasuritë e llojit kultura bujqësore "drufrutorë", për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

- Vlera totale e shpronësimit është 1,343,213 (një milionë e treqind e dyzetë e tre mijë e dyqind e trembëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE NË FSHATIN ROSHNIK", BERAT

Vlerësimi i pasurisë së llojit "tokë arë", është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016
Vlerësimi i kulturave bujqësore është kryer bazuar në udhëzimin nr. 1 datë 5.10.2000

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. totale	Sip. e shpronë suar	Pjesa takuese	Çmimi në lekë	Vlera e tokës arë	Vlera e kulturave bujqësore	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Sofia Teki Ndini	tokë arë	3195	403	1995	1195	1/4	203	60,646.25	275,157	335,803.25	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Kristo Esat Ndini						2/4		121,292.50	550,314	671,606.50	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Bukurosh e Esat Spaho						1/4		60,646.25	275,157	335,803.25	Konfirmuar nga ZVRPP
VLERA TOTALE PARAPRAKE					**1995**				**242,585**	**1,100,628**	**1,343,213**	

NJOFTIM
Nr. 6689, datë 6.5.2019

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE ME KOSOVËN

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës, e nënshkruar në Pejë, më 26.11.2018, ka hyrë në fuqi në datën 19.4.2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

NJOFTIM
Nr. 6783, datë 7.5.2019

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, e nënshkruar në Tiranë, më 18 korrik 2018, ka hyrë në fuqi në datën 3.5.2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

VENDIM
Datë 22.1.2019

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË LIKUIDIMIT VULLNETAR

SHOQËRIA TREGTARE "BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË" SH.A
NIPT: K31608802W

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE

Sot, më datë 21.1.2019, u mbajt Mbledhja e Aksionarëve për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës, si më poshtë vijon:

1. Kalimin e Bankës në procesin e likuidimit vullnetar;
2. Njoftimin paraprakisht të Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave mbi kalimin në likuidim vullnetar;
3. Zgjedhjen e kandidatit për likuidator që do t'i propozohen Bankës së Shqipërisë;
4. Të ndryshme.

Në mbledhje janë të pranishëm aksionarët e shoqërisë "Banka e Kreditit të Shqipërisë" sh.a., Fawzi M A Alkharafi, Marzouq N M A Alkharafi, Bader N M A Alkharafi, Faisal N M A Alkharafi, Hebah N M A Alkharafi, Hetaf N M A Alkharafi, Fawziya Sulaiman A.S.A Al-Rifai, Abdulmohsin J M A Alkharafi, Loay J M A Alkharafi, Eyad J M A Alkharafi, Talal J M A Alkharafi, Anwar J M A Alkharafi, Ahmad J M A Alkharafi, Ghalia J M A Alkharafi, SabeekaSa'adAljaser, të cilët përfaqësojnë

shumicën e aksioneve të shoqërisë në masën prej 100% të aksioneve duke bërë të vlefshme këtë mbledhje.

I. Për sa i përket pikës së 1-rë, të rendit të ditës, pasi shqyrtoi gjendjen aktuale të Bankës dhe duke marrë në konsideratë që aksionarët nuk synojnë të vazhdojnë të operojnë në tregun shqiptar, në bazë të legjislacionit në fuqi për bankat kanë vendosur kalimin në likuidim vullnetar të shoqërisë "Banka e Kreditit e Shqipërisë".

II. Për sa i përket pikës së 2-të, të rendit të ditës, bazuar në pikën 1/a, të nenin 107, të ligjit për bankat, i cili parashikon se "aksionarët e bankës ose vetë banka e huaj, në rastin e degës së bankës së huaj, vendosin vullnetarisht të kalojnë bankën në proces likuidimi. Në këtë rast banka ose dega e bankës së huaj njoftojnë paraprakisht për këtë vendim Bankën e Shqipërisë;";

Bazuar në pikën 3, të nenit 107, të ligjit për bankat, i cili parashikon se "Vendimi i likuidimit vullnetar i dërgohet njëkohësisht dhe Agjencisë se Sigurimit të Depozitave, për të ushtruar kompetenca të saj në bazë të ligjit "Për sigurimin e depozitave";

Vendosim që ky vendim asambleje përpara fillimit të efekteve i njoftohet paraprakisht Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

III. Për sa i përket pikës së 3-të, të rendit të ditës, bazuar në pikën 6, të nenit 107, të ligjit për bankat i cili parashikon se, "Për likuidimin vullnetar zbatohen edhe dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare", për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj".

Bazuar në pikën 1, të nenit 111, të ligjit për bankat, i cili parashikon "Banka e Shqipërisë emëron likuidatorin që do të marrë në posedim dhe në kontroll bankën ose degën e bankës së huaj gjatë procesit të likuidimit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj", si dhe

Bazuar në pikën 2, të nenit 91, të ligjit për shoqëritë tregtare, i cili parashikon "Në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare, likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme".

Pasi shqyrtoj disa kandidatura vendosi t'i propozojë Bankës së Shqipërisë për emërimin si likuidator, si vijon:

- Deloitte Albania sh.p.k., me përfaqësues z. Olindo Shehu.

Aksionarët duke mos pasur pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur mbështetur në legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi dhe Statutin e Shoqërisë,

VENDOSËN:

1. Prishjen e shoqërisë "Banka e Kreditit të Shqipërisë" dhe kalimin në likuidim vullnetar.
2. Vendimi sipas pikës 1, të njoftohet paraprakisht Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.
3. T'i përcjellë Bankës së Shqipërisë kandidaturat për emërimin si likuidator, si vijon:

- Deloitte Albania sh.p.k., me përfaqësues z. Olindo Shehu.

4. Likuidimi vullnetar dhe efektet e këtij vendimi do të fillojnë sipas ligjit për bankat.
5. Drejtoresha ekzekutive e shoqërisë apo çdo person tjetër i autorizuar prej saj, ngarkohet me njoftimin e këtij vendimi Bankës së Shqipërisë, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore për likuidimin vullnetar të Bankës.

Aksionarët e Shoqërisë
Fawzi M A Alkharafi
Marzouq N M A Alkharafi
Bader N M A Alkharafi
Faisal N M A Alkharafi
Hebah N M A Alkharafi
Hetaf N M A Alkharafi
Fawziya Sulaiman A.S.A Al-Rifai
Abdulmohsin Jassim J M A Alkharafi
Loay J M A Alkharafi
Eyad J M A Alkharafi
Talal J M A Alkharafi
Anwar J M A Alkharafi
Ahmad J M A Alkharafi
Ghalia J M A Alkharafi
SabeekaSa' adAljaser

COMMERCIAL COMPANY
"CREDIT BANK OF ALBANIA" SHA
NIPT: K31608802W

RESOLUTION
OF THE GENERAL ASSEMBLY
OF SHAREHOLDERS

Today, on 22.1.2019, was held the assembly of the shareholder to discuss and decide on the agenda below:

1. The placement of the bank in voluntary liquidation process.

2. The preliminary notification to the Bank of Albania and the Agency on the Deposit Insurance for the voluntary liquidation of the Bank.

3. The selection of the candidates for liquidator to propose to the Bank of Albania.

4. Others.

The meeting was attended by shareholders of the company "Credit Bank of Albania" Fawzi M A Alkharafi, Marzouq N M A Alkharafi, Bader N M A Alkharafi, Faisal N M A Alkharafi, Hebah N M A Alkharafi, Hetaf N M A Alkharafi, Fawziya Sulaiman A.S.A Al-Rifai, Abdulmohsin J M A Alkharafi, Loay J M A Alkharafi, Eyad J M A Alkharafi, Talal J M A Alkharafi, Anwar J M A Alkharafi, Ahmad J M A Alkharafi, Ghalia J M A Alkharafi, SabeekaSa'adAljaser, which represent the capital of the company in the amount of 100% of the shares, making valid this meeting:

I. Regarding the 1 (first) point of the agenda after reviewing the actual situation of the Bank and taking in consideration that the shareholders do not intend to be present anymore in Albanian market, based on the legislation on force on banks decided to place the bank into voluntary liquidation process.

II. Regarding the second point of the agenda based on point 1 (a), of the article 107 of the law on Banks which foresees that "the shareholder of the Bank or the foreign bank itself in the case of the branch of the foreign bank, decide to place the bank in voluntary liquidation. In this case the bank or the branch of the foreign bank previously for this decision the bank of Albania",

based on point 3, of the article 107 of the law on Banks which foresees that "the decision for the voluntary liquidation of the bank or the branch of the foreign bank for the exercise of its competences according the law on "Deposit insurance"

Decide that before the commencement of the effects, this decision should previously notify to the Bank of Albania and simultaneously to the Agency on the Deposit Insurance.

III. Regarding the third point of the agenda based on:

point 6, of article 107 on the law on Banks which foresees that "For the voluntary liquidation applies the regulation of the law on commercial companies, as long as they do not conflict with the regulation of this law",

based on point 1 of article 111 of the law on Banks, which foresees "The Bank of Albania appoint the liquidator that is going to take control and possession of the bank or the branch of the foreign bank during the liquidation process according the conditions foreseen in this law",

point 2 of article 91 of the law on commercial companies which foresees "In the limit liabilities companies and in joint stock companies the liquidation is done by the liquidator appoint by the general assembly of shareholders";

after evaluating some of the candidates decide to propose to the Bank of Albania the following:

- Deloitte Albania shpk represented by Mr. Olindo Shehu.

The shareholder not having any other issues to discuss, in accordance with the Albanian legislation in force on companies and the statute of the company:

RESOLVED:

1. The dissolution of the company "Credit Bank of Albania sh.a" and the placement of the company in voluntary liquidation.

2. The decision mentioned in the 1 (first) point should be notified preliminarily to the Bank of Albania and simultaneously to the Agency for the Deposit Insurance.

3. To submit to the Bank of Albania the following candidatures for liquidator:

- Deloitte Albania shpk represented by Mr. Olindo Shehu

4. The voluntary liquidation and the effects of this decision shall take place according the law on banks.

5. The Executive Director of the Company or any other person authorized by her shall take all the necessary steps to notify the Bank of Albania, Agency on Deposit Insurance, and the fulfilment of all legal actions for the voluntary liquidation of the Bank.

The Shareholders
Fawzi M A Alkharafi
Marzouq N M A Alkharafi
Bader N M A Alkharafi
Faisal N M A Alkharafi
Hebah N M A Alkharafi
Hetaf N M A Alkharafi
Fawziya Sulaiman A.S.A Al-Rifai
Abdulmohsin Jassim J M A Alkharafi
Loay J M A Alkharafi
Eyad J M A Alkharafi
Talal J M A Alkharafi
Anwar J M A Alkharafi
Ahmad J M A Alkharafi
Ghalia J M A Alkharafi
SabeekaSa' adAljaser

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë